

PLANI AFARIST

2016 – 2019

ODA EKONOMIKE E MAQEDONISË VERI-PERËNDIMORE

Themelimi i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore (OEMVP) është bërë në Tetovë në vitin 2005, duke numëruar 122 anëtarë. Dy vite më pas selia shpërngulet në Shkup, me rritje të dyfishtë të numrit të ndërmarrjeve të përfshira me OEMVP-në, si dhe bëhet zgjerimi i kapacitetit administrativ.

OEMVP në vitin 2015 shënoi 10-vjetorin e themelimit të saj. Gjatë këtyre dhjetë viteve OEMVP ofroi mbështetje të vazhdueshme për bizneset që veprojnë në vend, si dhe për klimën e biznesit në përgjithësi. Që nga vetë fillimi, OEMVP vazhdon të paraqesë një institucion në shërbim të ekonomisë, partner konstruktiv i institucioneve shtetërore, partner në dialogun shoqëror, mbështetje për politikën përkatëse makroekonomike, si dhe nxitës i zhvillimit ekonomik.

OEMVP orvatet për inkuadrimitin e sa më shumë ndërmarrjeve. Sot OEMVP numëron diku rreth 1.800 anëtarë – ndërmarrje që veprojnë në sektorë të ndryshëm dhe që janë pozicionuar në të gjitha rajonet në vend.

Gjatë këtyre dhjetë viteve, OEMVP ka organizuar 70 punëtori, 82 tryeza të rumbullakëta, mbi 800 takime dhe punëtori bilaterale, me të cilat janë përfshirë rreth 3.000 ndërmarrje aktive. OEMVP ka organizuar mbi 120 takime për ndërmjetësim afarist për anëtarët e vet me partnerë të huaj, nga të cilët 50 kanë si bazë bashkëpunimin partner me anëtarët tanë.

OEMVP është përfaqësuese legjitime e interesave të komunitetit afarist në Maqedoni, gjë kjo e cila kontribuon për zhvillimin e ndërmarrjeve, ndërsa profesionalizmi dhe vendosmëria ndihmon për afrimin e biznesit dhe shoqërisë drejt vlerave evropiane. Falë kësaj, OEMVP me sukses zbatoi një numër të madh projektesh të mbështetur nga Bashkimi Evropian, të cilët janë menduar kryesisht për ndërtimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të odave dhe ndërmarrjeve.

Për të qenë më afër ndërmarrjeve, në vitin 2012 OEMVP organizon “Odën Karvan”, si mundësi kontakti të drejtpërdrejtë me ndërmarrjet dhe mundësi për t’i vështruar nga afër problemet me të cilat po përballen ndërmarrjet gjatë punës së tyre.

OEMVP është njëri nga iniciatorët e “Sipërmarrësit të Vitit” që nga viti 2006, manifestim ky për shpërblimin e sipërmarrësve më të suksesshëm. Që nga viti 2010, është bërë tradicionale mbajtja e manifestimit “Top 100” për shpalljen e 100 ndërmarrjeve më të suksesshme të vitit.

Anëtarët e OEMVP-së aplikojnë mbështetje dhe praktika korporative për përgjegjësi shoqërore.

ODA EKONOMIKE E MAQEDONISË VERI-PERËNDIMORE	2
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4
1. KORNIZA	5
2. ROLI I OEMVP-SË DHE I VEPRUESVE TJERË	6
2.1. ARRITJET E DERITANISHME TË OEMVP-SË	6
2.2. AKTIVITETET E QEVERISË DHE TË VEPRUESVE TJERË	6
3. VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT	8
4. OBJEKTIVAT STRATEGJIK TË OEMVP-SË, MASAT DHE AKTIVITETET	8

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1. KORNIZA

Në periudhën në të cilën bie Plani Afarist, Republika e Maqedonisë do të shënojë 25-vjetorin të pavarësisë së saj. Nga këto 25 vite, 10 vitet e fundit Maqedonia gjendet në status quo në integrimet euroatlantike – akoma mban statusin e vendit kandidat për anëtarësi në BE dhe me mbështetje për anëtarësim në Aleancën NATO. Ngecja në integrimet euroatlantike, si dhe kriza politike në të cilën gjendet vendi gjatë viteve të fundit kanë ndikim negativ mbi zhvillimin ekonomik dhe merr të paktën një pikë procentuale të rritjes së PBB-së. Dalja nga kriza politike dhe përmirësimi i stabilitetit politik, si dhe progresi në integrimet euroatlantike mund të ofrojë nxitje të konsiderueshme të zhvillimit ekonomik.

Maqedonia ka arritur një progres të konsiderueshëm në lehtësimin e udhëheqjes së biznesit dhe Maqedonia, sipas Bankës Botërore, është radhitur në pozitën e 30-të (Doing Business 2012). Maqedonia, sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, ka shënuar progres në cilësinë e legjislacionit, në efektshmërinë e Qeverisë, në sundimin e ligjit dhe në luftimin e korrupsionit. Megjithatë, mbetet hapësirë plotësuese për përmirësimin e cilësisë së legjislacionit dhe efektshmërisë së Qeverisë, ndërsa në sundimin e ligjit dhe luftimin e korrupsionit nevojiten akoma hapa të konsiderueshëm. Pavarësisht nga progresi në sistemin ligjor, ai, njëjtë si politika ndëshkuese, paraqesin një problem të konsiderueshëm, pasi janë ngarkesë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Problem janë ndryshimet e shpeshta të ligjeve dhe normave ligjore, gjëra këto të cilat e bëjnë të pamundshëm planifikimin e biznesit, si dhe moskonsultimi i bizneseve në lidhje me ndryshimet. Ndëshkimi i cili paraqiste një problem shumë të madh, u reformua në mënyrë që gjodat t'i përshtaten madhësisë së ndërmarrjes dhe të aplikohet parimi: njëherë mësim, e pastaj gjokitje.

Njëra nga pengesat kryesore për sektorin e biznesit në Maqedoni mbetet të jetë qasja në financa. Rritja e ndërmarrjeve është kufizuar vetëm deri në lartësinë e mjeteve financiare vetanake ose me ndihmën e rrjeteve joformale. Kapaciteti i plotë i ndërmarrjeve, e sidomos i anëtarëve të OEMVP-së nuk mund të arrihet pa një financim përkatës të jashtëm. Bankat shpesh theksojnë se projektet e qëndrueshme me nivel të pranueshëm të rrezikut financohen nga bankat. Përkundër kësaj, ndërmarrjet pretendojnë se pragu i rrezikshmërisë së pranueshme është shumë i lartë dhe se bankat nuk bazohen mbi vlerësimin e biznesit, por mbi sigurimin e mundshëm, i cili shpeshherë është tepër i lartë. Sigurimi është problem sidomos për ndërmarrjet, pronat e të cilave gjenden në rajone me çmime më të ulëta në tregun e patundshmërive (p.sh. zonat rurale). Ndërmarrjet konsiderojnë dhe se shkallët e interesave janë tejet të larta, kurse procedurat e miratimit të kredisë janë tepër të komplikuar dhe marrin shumë kohë.

Ndërmarrjet përplasen dhe me problemin e tregut të vogël dhe konkurrueshmërisë së ulët. Sfidë të madhe paraqet dhe internacionalizimi dhe rritja e konkurrueshmërisë dhe modernizimit të ndërmarrjeve. Brengosës është përqëndrimi i ndërmarrjeve në Shkup përkundër pjesës tjetër të vendit. Ai është më i lartë në numër dhe më përparimtar në kryeqytet, sesa në pjesët tjera, e sidomos

në zonat rurale. Vendi po përballet me një sfidë të madhe në sigurimin e zhvillimit të balancuar rajonal.

Të dhënat statistikore për rajonet në RM 8

2. ROLI I OEMVP-SË DHE I VEPRUESVE TJERË

2.1. ARRITJET E DERITANISHME TË OEMVP-SË

Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore (OEMVP), që nga themelimi i saj në vitin 2005, me diku rreth 122 anëtarë, për dhjetë vite u zhvillua në një Odë e cila numëron 1.800 anëtarë. Dy vite pas themelimit, OEMVP u shpërngul nga Tetova në Shkup.

OEMVP në vitin 2015 shënoi përvjetorin e 10-të nga themelimi i saj. Gjatë këtyre dhjetë viteve, OEMVP ofroi mbështetje të vazhdueshme për ndërmarrjet që veprojnë në vend, si dhe përmirësimin e ambientit të biznesit në përgjithësi.

Në Strategjinë paraprake për vitet 2013 – 2015, OEMVP definoi vizionin dhe misionin e vet, si dhe pesë objektivat strategjik:

- rritja e kredibilitetit dhe prestigjit të OEMVP-së në mesin e anëtarëve të vet dhe anëtarëve të mundshëm:
- zhvillimi i portofolit përkatës (volumit) të shërbimeve të OEMVP-së;
- promovimi i konkurrueshmërisë dhe sipërmarrësisë;
- promovimi i zhvillimit të balancuar rajonal;
- krijimi i mjedisit për thithjen e investimeve të huaja (diaspora).

Veç kësaj, në bashkëpunimin e saj, OEMVP ka dy objektiva: zhvillimin e partneriteteve dhe rrjeteve, si dhe ngritjen e dukshmërisë së OEMVP-së, kurse në organizimin e saj, poashtu janë vendosur dy objektiva: strukturë efikase organizative dhe staff profesionist të përkushtuar.

Disa nga aktivitetet të cilat kontribuojnë për më shumë objektiva të OEMVP-së janë: “Sipërmarrësi i Vitit”, i bashkë-organizuar që nga viti 2006, manifestimi për shpërblimin e sipërmarrësve më të suksesshëm, dhe “Top 100” për shpalljen e 100 ndërmarrjeve më të sukseshme të vitit, që nga viti 2010.

OEMVP tenton të përfshijë ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme (NVM), me theks të veçantë mbi gratë, të rinjtë, zonat rurale, të cilat veprojnë në territorin e Maqedonisë Veri-Perëndimore.

2.2. AKTIVITETET E QEVERISË DHE TË VEPRUESVE TJERË

2.2.1. POLITIKAT DHE AKTIVITETET QEVERITARE

Maqedonia ka nevojë për një zhvillim të përshpejtuar ekonomik (5 deri 7%), për të filluar zgjidhjen e problemeve më të mëdha shoqërore: papunësia dhe varfëria.

Për këtë qëllim, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, mes tjerash, do të vazhdojë dhe me masat për:

- përmirësimin e klimës së biznesit dhe rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë maqedonase. Masat do të orientohen drejt pakësimit të byrokracisë dhe reduktimit të shpenzimeve dhe procedurave për nxjerrjen e dokumenteve administrative, nëpërmjet të aplikimit elektronik dhe marrjes së lejeve;
- përmirësimin e konkurrueshmërisë së ekonomisë maqedonase, nëpërmjet të lidhjes së firmave me universitetet dhe novatorët për arsye të zbatimit të projekteve të përbashkëta hulumtuese dhe zhvillimore;
- përmirësimin e qasjes në kredi me sigurimin e linjeve të reja kreditore;
- financimin dhe mbështetjen e eksportit përmes disa produkteve të reja kreditore për eksportuesit: faktoringun eksportues dhe sigurimin e punës së kompanive që bashkëveprojnë me vende të jashtme.

Shërbimet e veta financiare Qeveria përqëndron në kuadër të Bankës Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit (BMMZH – www.mbdp.com.mk) dhe përmes Agjencisë për Mbështetjen e Sipërmarrësisë së Republikës së Maqedonisë (www.apprm.org.mk).

2.2.2. VEPRUESIT TJERË

Në Maqedoni, përveç OEMVP-së, aktive janë dhe dy oda më të mëdha : Oda Ekonomike e Maqedonisë (OEM) dhe Lidhja e Odave Ekonomike të Maqedonisë (LOEM). Në disa vitet e fundit po themelohen organizata të punëdhënësve si partnerë në dialogun shoqëror. Më të njohura janë Organizata e Punëdhënësve të Maqedonisë (OPM), organizatë kjo motër e OEM-së, dhe Konfederata e Biznesit.

Në Maqedoni, një burim gjithnjë e më dominues i mbështetjes po bëhet Komisioni Evropian, i cili siguron qasje nëpërmjet të instrumentit të tij IPA dhe programeve CIP, Progress dhe FP7. Përveç BE-së, akoma e pranishme është USAID, e cila shpall thirrje për mikrofinancim dhe sipërmarrësi, por megjithatë pritet që mbështetja të ndjek një trend rënës dhe me trajtim të preferueshëm të institucioneve që kanë përvojë paraprake me USAID-in. Një prani më të rëndësishme të institucioneve financiare ndërkombëtare kanë EBRD dhe IFC, të cilat më tepër përqëndrohen në institucionet financiare dhe ndërmarrjet më të mëdha.

Kohëve të fundit u shfaqën dhe një varg organizatash tjera për zhvillimin e sipërmarrësisë, si për shembull: Shoqata Evropiane e Biznesit, Qendra për Zhvillimin e Bizneseve të Reja (BSC), Fondacioni YES, CEED, etj.

3. VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT

Vizioni i OEMVP-së është që të jetë lider në përfaqësimin e interesave të biznesit dhe në krijimin e një ambienti më të favorshëm për zhvillim.

Misioni i OEMVP-së është që të organizojë, avancojë, mbrojë dhe promovojë interesat afariste brenda dhe jashtë vendit, së bashku me sfidat e konkurrencës globale.

Vlerat e OEMVP-së janë: transparenca, partneriteti, qëndrueshmëria, qasja e barabartë.

- Pjesëmarrja – OEMVP kërkon përfshirjen e biznesit në vendimsjelljen në nivelin kombëtar dhe atë lokal lidhur me çështje të cilat prekin atë, dhe njëkohësisht duhet patjetër të sigurojë dhe përfshirjen e ndërmarrjeve anëtare të OEMVP-së në vendimsjellje;

- Sipërmarrësia – ndërmarrjet anëtare të OEMVP-së kanë arritur sukses, pasi kanë ndërmarrë nismën e suksesit vetanak dhe besojnë fuqishëm se është kjo rruga drejt suksesit të komunitetit dhe vendit. Me këtë, OEMVP identifikon se sipërmarrësia e suksesshme duhet të ndihmojë suksesshëmërinë e të tjerëve dhe të shoqërisë;

- Transparenca – OEMVP është shembull i një organizate të hapur dhe të përgjegjshme. Në gjendje kur lufta kundër ndikimeve partiake është vendimtare për bizneset dhe sundimin e ligjit, si dhe për luftimin e korrupsionit, OEMVP themelon lidhësin me shembull në transparenca;

- Partneriteti – OEMVP është rezultat i partneritetit të ndërmarrjeve që janë bashkuar për të arritur objektivat e tyre të përbashkëta dhe ajo do ta ushqejë partneritetin me veprues tjerë: odat tjera dhe organizatat e biznesit, agjencitë dhe institucionet, organizatat qytetare;

- Qëndrueshmëria – për të ushtruar rolin e vet, OEMVP duhet qenë e qëndrueshme, afatgjatë, të sigurojë vazhdimësi në veprim;

- Qasja e barabartë – OEMVP beson dhe është promovuese e qasjes së barabartë të ndërmarrjeve, dhe është kundër pengesave partiake, ideologjike, gjinore, të brezeve, gjeografike, ose pengesave në biznes.

4. OBJEKTIVAT STRATEGJIK TË OEMVP-SË, MASAT DHE AKTIVITETET

Duke u bazuar mbi kontekstin e përgjithshëm, nevojave prioritare, aktiviteteve të vepruesve tjerë, si dhe mbi rolin e vet, OEMVP definon pesë objektiva strategjik për periudhën e viteve 2016 – 2018, si vijon:

- legjislacioni më i mirë dhe aplikimi i tij më i ndershëm dhe sundimi i ligjit;
- qasja e përmirësuar në financa;
- promovimi i sipërmarrësisë (shoqërore), i risive, i konkurrueshmërisë, i përgjegjësisë shoqërore të ndërmarrjeve dhe i rajonalizimit/internacionalizimit të bizneseve;

- OEMVP – Odë me kredibilitet dhe prestigj, e aftë për të tërhequr anëtarë të ri dhe e gatshme për partneritete të fuqishme për ndikim më të madh;
- OEMVP me organizim efektiv dhe profesionalitet dhe kompetencë të dëshmuar;
- OEMVP me komunikim të përmirësuar me veprues të jashtëm.

Për të arritur këto objektiva, OEMVP do të veprojë me ndihmën e përfaqësimit, zhvillimit të kapaciteteve dhe sigurimit të portofolit përkatës të shërbimeve për ndërmarrjet.

OEMVP edhe më tej do t'i japë përparësi inkuadrimit të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NVM), me theks të posaçëm mbi gratë, të rinjtë dhe zonat rurale, të cilat veprojnë në territorin e Maqedonisë Veri-Perëndimore. OEMVP do të fillojë këshillime me anëtarësinë për **zgjerimin e shtrirjes gjeografike** nga Maqedonia Veri-Perëndimore në tërë territorin e vendit.

(Zhvillimi i balancuar rajonal)

Legjislacioni më i mirë dhe aplikimi i tij i ndershëm dhe sundimi i ligjit

OEMVP angazhohet për përmirësimin e aplikimit të legjislacionit (ligjeve, rregullave) për një ambient më të mirë të biznesit, para së gjithash, me ndihmën e përmirësimit të pjesëmarrjes së Odës, anëtarëve dhe organizatave tjera të biznesit në sjelljen e tij. OEMVP do të kërkojë që të jetë detyrimisht e konsultuar gjatë sjelljes/ndryshimit të legjislacionit, duke iu bashkëngjitur Komitetit Ekonomiko-Social, me pjesëmarrjen e saj në punën e komisioneve parlamentare dhe me konsultime bilaterale.

Për këtë objektiv, OEMVP do të bashkëpunojë me Qeverinë, gjë kjo e cila nuk përjashton kritizimin e politikave dhe legjislacionit. OEMVP do të orvatet që të krijojë qëndrimin dhe mendimin e vet sa iu përket politikave dhe legjislacionit më të rëndësishëm kombëtar.

Në politikat dhe legjislacionin në të gjitha nivelet, si dhe në administratën në të gjitha nivelet, patjetër duhet aplikuar parimin “mendo për të voglin njëherë”. Ndërmarrjet mikro dhe të vogla parimisht duhet të shkarkohen nga rregullat, tarifat dhe gjobat e shumta. Tatimet duhet të përshtaten sipas mundësive të ndërmarrjeve mikro dhe të vogla. Nevojitet siguri i qasjes në kushte të lehtësuara të financimit, si dhe rrjetëzimi i ndërmarrjeve mikro dhe të vogla.

Ndërmarrjeve duhet t'u sigurohet më tepër kohë për përshtatje ndaj ndryshimeve në legjislacion, me ndihmën e fushatave më të mëdha për informim, ku do të përfshihen organizatat e biznesit dhe OEMVP.

OEMVP do të angazhohet për rritjen e efektshmërisë së Qeverisë dhe administratës publike. Në punën e vet, inspektimet duhet qenë të ndershme dhe ato nuk guxojnë të jenë të motivuara në bazë fetare, etnike ose partiake. Qasja e ndershme duhet të sigurohet dhe në furnizimet publike, gjithashtu pa diskriminim, i cili është i motivuar në bazë fetare, etnike ose partiake.

Aktivitetet	Treguesit	Rezultatet
Takimet vjetore me Kryeministrin dhe ministrat në Qeveri	1 takim	
Ndjekja e sjelljes së legjislacionit Përgatitja e alarmeve për anëtarësinë Përpilimi i qëndrimit të OEMVP-së lidhur me politika dhe legjislacion të rëndësishëm	Ndjekja e ENER-it Alarmet e përgatitura mujore për hartimin e legjislacionit të ri 4-5 qëndrime të përpiluara	OEMVP i inkuadruar dhe i konsultuar mbi sjelljen dhe zbatimin e legjislacionit
Pjesëmarrja në punëtori dhe takime bilaterale	Takimet e siguruar	

Qasja e përmirësuar në financa

OEMVP do të angazhohet për një qasje të përmirësuar në financa për biznesin. Kjo duhet të përfshijë aktivitete për uljen e shkallëve të interesit për bizneset, sigurimin e subvencioneve qeveritare për kredi investimi.

OEMVP inkurajon shërbime të reja financiare për faza të ndryshme të zhvillimit të ndërmarrjeve dhe madhësi të ndryshme të ndërmarrjeve. Vëmendje të posaçme duhet t'i kushtohet inkurajimit të kreditimit të NVM. Për qasje të ndërmarrjeve duhet nga zonat rurale të zhvillohen fonde garancie, të cilët do ta kompensojnë problemin me vlerën më të ulët të pronave për sigurim të kredive. Duhet të zhvillohen fonde investimi për ndërmarrjet e reja dhe ato në rritje.

OEMVP do të veprojë dhe në drejtim të thjeshtësimit të procedurave kreditore dhe të trajnimit financiar dhe të shërbimeve të konsultimit të ndërmarrjeve.

OEMVP do të angazhohet që bankat, e sidomos bankat partnere të OEMVP-së, të vendosin një bashkëpunim më të mirë me anëtarët e OEMVP-së. Kjo ngërthen në vete hapjen e filialeve në zonat ku veprojnë anëtarët, për të arritur një përfshirje më të mirë gjeografike, zhvillimin e veglave, fletë-aplikimeve, dokumenteve në gjuhën shqipe dhe në gjuhët tjera që përdorin anëtarët, si dhe punësimin e zyrtarëve bankarë që zotërojnë ato gjuhë.

OEMVP do ta hulumtojë mundësinë e themelimit të një banke amerikane, si dhe mundësitë e një banke islame.

OEMVP vështron diasporën jo vetëm si mbështetës i konsumit, por dhe si investitor. Diaspora si investitor është e gatshme të investojë në viset (vendlindjet) ku investitorët e huaj nuk janë të gatshëm për të investuar. Për ta nxitur këtë proces, nevojitet që diaspora të përfshihet në aktivitete promotive të Qeverisë, për ta lehtësuar punën valutore dhe financiare me vendet e huaja, si dhe aktivitete tjera për lehtësimin e investimeve nga diaspora.

Aktivitetet	Treguesit	Rezultatet
Takimi vjetor i anëtarëve me udhëheqësinë më të lartë të bankave partnere të OEMVP-së	1 takim vjetor	
Përpilimi i qëndrimeve të OEMVP-së për çështje lidhur me financat	2-4 qëndrime të përpiluara	Qasja më e mirë në financa
Vizita anëtarëve nga bankat partnere	3 vizita	
Karvani Financiar – takime komunale të anëtarëve dhe bankave	10 takime në komuna	

Promovimi i sipërmarrësisë (shoqërore), i risive, i konkurrueshmërisë, i përgjegjësisë shoqërore të ndërmarrjeve dhe i rajonalizimit/internacionalizimit të bizneseve

Përqëndrimi i shfrytëzimit të potencialit sipërmarrës të brendshëm është vendimtar.

OEMVP do të vazhdojë me masa dhe aktivitete për nxitjen e sipërmarrësisë dhe risive, përfshirë këtu dhe shquarjen e shembujve pozitiv nëpërmjet të aktiviteteve siç është “Sipërmarrësi i Vitit”, ose publikimi “Top 100”. Theks të veçantë dhe masa afirmative nevojiten për gratë sipërmarrëse.

Për një konkurrueshmëri të ndershme, OEMVP do të angazhohet për vendosjen e barazisë midis investitorëve të huaj dhe investitorëve të brendshëm. Gjithashtu, OEMVP do të angazhohet për kushte të njëjta të punës për sektorin publik dhe atë privat, si për shembull, disiplina financiare ose të drejtat nga marrëdhëniet e punës.

Përveç motivimit kryesor për gjenerimin e fitimit, OEMVP do t'i udhëheq dhe shtytjet filantropike të kompanive për përkrahjen e njerëzve dhe komuniteteve, si dhe të mjedisit, nëpërmjet të fuqizimit të përgjegjësisë shoqërore të ndërmarrjeve. Veç kësaj, e sidomos në pjesën e grupeve të lëndueshme – të rinjtë, gratë dhe komunitetet pakicë, OEMVP do të jetë prijës i sipërmarrësisë shoqërore në vend.

Për shkak të kufizimit në tregun e brendshëm, rajonalizimi/internacionalizimi paraqesin domosdoshmëri përpara ndërmarrjeve anëtare të OEMVP-së. Anëtarët e OEMVP-së, për shkak të disa faktorëve, përfshirë këtu dhe shumëgjuhëshmërinë dhe rrjetet e vendosura afariste, kanë parakushte të shkëlqyera ta udhëheqin rajonalizimin/internacionalizimin e ndërmarrjeve në Maqedoni. Për ta realizuar këtë objektiv, është i domosdoshëm modernizimi i ndërmarrjeve (teknologjitë e reja, vendosja e teknologjive informatike), aplikimi i standardeve të cilësisë (HACCP, ISO), ose standardeve që mundësojnë qasje në tregje të reja (Halal, Kosher).

Aktivitetet	Treguesit	Rezultatet
Çmimi “Sipërmarrësi i Vitit”	1 takim vjetor	Nxitja e sipërmarrësisë
“Top 100”	Publikimi dhe promovimi	
Përpilimi i qëndrimeve të OEMVP-së për çështjet lidhur me temën	2 qëndrime të përpiluara	Konkurrenca e ndershme
Shërbimet për anëtarët		Konkurrueshmëria, rajonalizimi/internacionalizimi

OEMVP – Odë me kredibilitet dhe prestigj, e gatshme për partneritete të fuqishme për ndikim më të madh

OEMVP është një organizatë e pavarur dhe një organizatë me kredibilitet, ashtu siç është njohur deri më tani. OEMVP bashkëpunon me Qeverinë dhe institucionet shtetërore, por bashkëpunimi i tillë nuk do të thotë dhe mostheksimin e qëndrimeve të qarta dhe të kundërta për çështjet kryesore që kanë të bëjnë me biznesin.

OEMVP duhet të zhvillojë partneritete të fuqishme dhe efektive, brenda dhe jashtë vendit, në rajon dhe më gjerë.

OEMVP do të vëjë theks të posaçëm mbi bashkëpunimin me Odën Ekonomike të Maqedonisë (OEM) dhe Lidhjen e Odave Ekonomike të Maqedonisë (LOEM), dhe çdoherë kur është e mundur, do të tentojë të formulohen qëndrime të përbashkëta dhe të merret pjesë në aktivitete të përbashkëta.

Në rajon OEMVP do të punojë drejt themelimit të marrëdhënieve të shkëlqyera me odat ekonomike të Turqisë, Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe të vendeve tjera të rajonit.

OEMVP do t'i ekzaminojë mundësitë e bashkëngjitjes në rrjete evropiane dhe globale.

OEMVP do ta ekzaminojë brendimin e vet, si bazë për ndërtimin e marrëdhënieve me publikun.

Ndërtimin plotësues të marrëdhënieve me publikun OEMVP do ta bazojë mbi pjesëmarrjen e shtuar në media, përfshirë këtu dhe me deklarata, mendime dhe qëndrime në programet informative, ose me pjesëmarrje në emisione debative.

Aktivitetet	Treguesit	Rezultatet
Pjesëmarrja në takime me OEM dhe LOEM	Numri dhe cilësia e takimeve	
Takimet me odat e rajonit	Numri dhe cilësia e takimeve	Partneritete më të fuqishme
Anëtarësia në rrjete ndërkombëtare		
Deklaratat për mediat dhe pjesëmarrjet në emisione debative	Numri dhe cilësia e deklaratave dhe debateve (Press Clipping)	Marrëdhënie të përmirësuara me publikun

OEMVP me organizim efektiv, joshës për anëtarët dhe me profesionalizëm dhe kompetencë të dëshmuar

Të gjithë objektivat e vet paraprak, OEMVP mund t'i realizojë vetëm nëse do të jetë një organizatë efektive – organizatë e cila jep rezultate, e cila është joshëse për anëtarët, anëtarët aktual të mbahen, si dhe të joshen anëtarë të ri, dhe e cila ka profesionalizëm dhe kompetencë të dëshmuar.

OEMVP i është përkushtuar rritjes së numrit të anëtarëve, si dhe diversifikimit të tyre sipas sektorëve nga vijnë, dhe rritja e numrit të anëtarëve të themeluar nga gra. Posaçërisht është e rëndësishme që anëtarët të jenë aktiv në Odë. Me këtë, OEMVP duhet të hartojë një Strategji për joshjen e anëtarëve të ri, duke zbatuar vizita nga dera në derë.

Për të qenë një organizatë joshëse për anëtarët, ajo duhet qenë efektive, të realizojë rezultate që u nevojiten anëtarëve. OEMVP patjetër duhet qenë transparente dhe pjesëmarrëse për anëtarët, nëpërmjet të transparencës dhe inkuadrimin në punën e organeve të OEMVP-së, nëpërmjet të informimit të rregullt. Do të vendosen mënyra të rregullta të komunikimit, si nëpërmjet të informatorëve, ashtu dhe nëpërmjet të mediave të reja (ueb faqes, Facebook faqes, Blog-ut).

OEMVP do të vazhdojë dhe komunikimin e drejtpërdrejtë, me “Karvanin e Odës”, organizimin e takimeve në rajonet e ndryshme, ku OEMVP do t’i vizitojë anëtarët.

OEMVP do të themelojë një bazë interaktive të të dhënave për anëtarët.

Njëra nga çështjet të cilat do të shqyrtohen do të jetë bilanci midis të drejtave dhe obligimeve, para së gjithash, pagimi i taksës së anëtarësisë, si dhe vendosja e taksës së anëtarësisë sipas madhësisë së ndërmarrjes.

OEMVP është në përmirësim të vazhdueshëm të transparencës dhe përfshirjes në punën e organeve të veta, duke e inkuadruar dhe informuar anëtarësinë për punën e organeve. Në organet e OEMVP-së duhet të përmirësohet pjesëmarrja e anëtarëve të themeluar nga gra dhe të rinj, të ketë përfaqësim përkatës të rajoneve dhe sektorëve.

OEMVP do ta përcaktojë nevojën për organizim në grupacione sipas sektorëve dhe formalizimin e tyre.

OEMVP do ta shqyrtojë nevojën për një organizatë të punëdhënësve si partner formal në dialogun ekonomiko-social.

OEMVP do të ndërtojë një kapacitet të brendshëm, i cili do të punësojë staf përkatës, profesionist dhe kompetent. Në të njëjtën kohë, zyra ekzekutive do ta përmirësojë llogaridhënien dhe përgjegjësinë e saj, si për rezultatet, ashtu dhe për financat.

Do të punohet në drejtim të përmirësimit të kapacitetit të përgjithshëm dhe të Bordit Drejtues, Bordit Mbikëqyrës dhe Zyrës Ekzekutive të OEMVP-së, me trajnime të përbashkëta ose vizita studimore të shembujve të suksesshëm.

Aktivitetet	Treguesit	Rezultatet
Rritja e anëtarësisë Rritja e anëtarësisë aktive (taksa e anëtarësisë) Rritja e anëtarëve të themeluar nga gra	Numri dhe diversifikimi i anëtarëve	Joshja e anëtarësisë
Informatori Mediat e reja Karvani i Odës	Numri i informatorëve Numri i depërtimeve të postimeve	
Baza e anëtarëve		Menaxhimi më i mirë
Seancat e rregullta dhe mirë të organizuara të organeve	Numri dhe cilësia e seancave	
Struktura organizative (përkufizimi i përgjegjësive) dhe sistematizimi i punëve dhe vendeve të punës		Zyra Ekzekutive me staf profesionist
Trajnimet, vizitat studimore		
Sistemet dhe proceset e përshtatura organizative		
	Standardi ISO i aplikuar	

OEMVP – shërbimet për anëtarët